



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:028683

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06921583

C.nr.476/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.B. me numër personal dhe P.S., me numër personal që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim e përfaqëson av. B.M.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 162.12 euro, jashtë seance me datë 28.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve R.B. dhe P.S. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit në pagë konform shkallës së inflacionit, të paguajë shumat dhe atë:

- Për paditësen R.B. për periudhën kohore 01.10.2022 - 20.11.2022, shumën prej 81.06 euro;
- Për paditësin P.S. për periudhën kohore 01.10.2022 - 20.11.2022, shumën prej 81.06 euro;

Të gjitha këto në shumë totale **162.12 euro**, deri në pagesën definitive, duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8% prej ditës së paraqitjes së padisë (25.01.2024), në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura, që paditëseve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsy et im

Paditëset R.B. dhe P.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së tyre av. B.M.K. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 25.01.2024, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në institucionin arsimor SHFMU "Motrat Qiriazi" në Prizren, nuk kanë pranuar mjetet e parapara për kompensimin e shpenzimeve të inflacioni në pagë, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitin 2022 ka qenë 11.6%, secilës paditëse për 1 muaj e 20 ditë takon shuma në lartësi prej 81.06 euro, pra në shumën e përgjithshme 162.12 euro, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditësës është e pa bazuar, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi i lëshuar nga shkolla SHFMU "Motrat Qiriazhi" në Prizren, me numër 519/63, të datës 13.12.2023, për paditësen Ramzia Bajrami vërtetohet se është në marrëdhënie në pune si mësimdhënëse që nga viti 1987 dhe ende vazhdon të jetë në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle. Bazuar në Listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses Ramzia Barami është shuma prej 421.00 euro, gjithashtu nga vërtetimi i lëshuar shkolla SHFMU "Motrat Qiriazhi" në Prizren, me numër 519/62, të datës 13.12.2023 për paditësen Pranvera Smani vërtetohet se është në marrëdhënie si mësimdhënëse që nga viti 2001 dhe ende vazhdon të jetë në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle. Bazuar në Listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses Pranvera Smani është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo kaktohet në të".

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se "Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë", si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që "Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve" ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i

takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për Paditësen R.B.

Për periudhën 1 Tetor 2022 - 20 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 48.83euro ($421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 1 \text{ muaj} = 48.83$), si dhe për 20 ditë të muajit nëntor ($48.83 \div 30 = 1.61 \times 20 \text{ ditë} = 32.20$ euro) apo në shumën e përgjithshme prej 81.06 euro.

- Për Paditësen P.S.

Për periudhën 1 Tetor 2022 - 20 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit Süleyman Dasi ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 48.83euro ($421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 1 \text{ muaj} = 48.83$), si dhe për 20 ditë të muajit nëntor ($48.83 \div 30 = 1.61 \times 20 \text{ ditë} = 32.20$ euro) apo në shumën e përgjithshme prej 81.06 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (25.01.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve,

lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni Civil
C.nr.476/2024, me datë 28.02.2025

Gjyqtari

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.